



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

Nr. Prot. 1015 Dt. 28.04.2022

<b>PËR:</b>	- <b>Dekanët e njësive akademike të UIBM-së</b>
<b>CC:</b>	- <b>Prorektorët</b> - <b>Parlamentit Studentor</b> - <b>Zyra për Informim dhe komunikim me publikun</b>
<b>NGA:</b>	- <b>Prof. dr. Alush Musaj, rektor i Universitetit "Isa Boletini", Mitrovicë</b>
<b>TEMA:</b>	- <b>Ecuria e aktiviteteve zhvillimore</b>



Të nderuar dekanë,

Në kuadër të aktiviteteve me karakter zhvillimor në UIBM, po ndajmë me ju disa informacione të rëndësishme të lidhura me proceset aktuale që kanë të bëjnë me vizionin e UIBM-së dhe planifikimet e secilës njësi akademike në harmoni me këtë vizion për të paktën tre vitet e ardhshme.

- Në mbledhjen e fundit të Senatit, kemi diskutuar përgatitjet për konkurs për pranimin e personelit të ri akademik. Gjatë këtyre përgatitjeve, ju lutemi të merrni në konsideratë programet aktuale, por edhe programet e reja dhe nivelin e studimeve që njësia juaj akademike synon të ketë. Analiza e treguar në tabelën e mëposhtme përmban numrin e orëve të mësimit të zhvilluara në këtë vit akademik nga secila NJA, nga e cila ka dalë numri i nevojshëm i personelit të rregullt akademik. Kjo është një analizë e thjeshtë orientuese, por secila prej njësive akademike, mbështetur në vizionin e saj, duhet të bëjë kërkesën për personel të ri akademik, që i siguron, jo vetëm qëndrueshmëri të programeve, por edhe program/e të ri/ja. Studimet doktorale në shkencat teknike mirëpritën të jenë prej këtij viti, ndërsa nga programet e shkencave sociale mirëpresim propozimet për studimet master apo për programe të reja me interes.



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

### LLOGARITJE E PËRAFËRT E VENDEVE TE NEVOJSHME PËR PERSONEL TË RI AKADEMIK

Llogaritja e orëve është bërë për vitin akademik 2021-2022. Të dhënat e stafit: MARS, 2022

Fakulteti	Personeli akademik i rregullt	Personeli akademik i angazhuar	Orët e mësimt semestri dimëror L/U	Orët e mësimt semestri veror L/U	NUMRI I STAFIT TË NEVOJSHËM ME NORMË!
Fakulteti i Gjeoshkencave	23 Profesorë 6 Asistentë	10	178/6=30 139/10=14	146/6= 24 91/10=9	Profesorë = 27 Asistentë = 12
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	16 Profesorë 3 Asistentë	10	130/6=21 114/10=11	105/6=17 96/10=10	Profesorë = 20 Asistentë = 10
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	13 Profesorë 9 Asistentë	1	121/6=20 146/10=14	124 /6 = 20 134 / 10 = 13	Profesorë = 27 Asistentë = 12
Fakulteti Juridik	9 Profesorë 1 Asistentë	1	54/6= 26/10= 3	60/6=10 33/30=3	Profesorë = 10 Asistentë = 3
Fakulteti Ekonomik	7 Profesorë 4 Asistentë	1	32/6=5 38/10=4	38/6=6 36/10=3	Profesorë = 6 Asistentë = 4
Fakulteti i Edukimit	7 Profesorë 6 Asistentë	10	105/6= 17 86/10=8	86 /6 = 14 76/10 = 7	Profesorë = 16 Asistentë = 8

[Shënim: L=Ligjërata; U=Ushtrime; 6 = norma për Prof.; 10 = norma për asistent]

- Nga analiza e numrit të studentëve që kemi regjistruar këtë vit akademik, duhet marrë në konsideratë fakti që në programet e shkencave teknike, po pranohet gjysma e studentëve krahasuar me numrin, sipas vendimeve të AKA-së. Edhe pse është një dukuri për të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë, mirëpresim analizimin e gjendjes dhe ndryshimet/përmirësimet/propozimet që programet tona të UIBM-së të jenë më atraktive për studentët e ardhshëm, duke pasur parasysh kushtet optimale që ofron UIBM.
- Në kuadër të përgatitjeve për vitin e ri akademik, ju lutemi që të planifikoni veprimtaritë me qëllim promovimin e programeve tona dhe promovimin e UIBM-së dhe këtë planifikim ta ndani edhe me zyrat përkatëse në UIBM-ë. Zyra e Informimit dhe e Karrierës, së bashku me Parlamentin e Studentëve janë të gatshëm t'ju mbështesin.



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

---

- Kërkesat e reja të KShC-AKA kanë rritur nevojën e përfshirjes në projekte hulumtuese, jo vetëm të stafit bartës të programeve, por të gjithë profesorëve të programeve. Në procesin e vlerësimit që po kalojnë tani programet, ka qenë kërkesë e vazhdueshme nga ekspertët edhe përfshirja e studentëve në hulumtime së bashku me stafin, shfrytëzimi i literaturës vendore dhe të huaj dhe sigurimi i origjinalitetit të punës kërkimore.
- Menaxhmenti i UIBM-së ka filluar draftimin e një Plani të Veprimit/aksional për vitin 2022, i cili do të përmbajë aktivitetet qenësore për ecurinë dhe zhvillimin cilësor të UIBM për këtë vit. Ky Plan do të vlejë deri në hartimin e Planit Strategjik të UIBM nga KD. Draftin e planit të veprimit/aksional do t’jua përcjellim brenda javës, në të cilin mirëpresim që të shtoni aktivitetet që i konsideroni të domosdoshme për njësinë tuaj akademike. Ne e vlerësojmë shumë imputin tuaj në këtë plan. Po ashtu, ju inkurajojmë që deri në hartimin e Planit Strategjik për UIBM, ju të hartoni planin e veprimit/aksional për këtë periudhë për njësitë tuaja akademike. Dokumentet e tilla si: raportet e monitorimit që keni bërë për planin e vitit të kaluar, raportet e cilësisë të punuara nga Zyra e cilësisë dhe të publikuara në ueb, si dhe raporti vlerësues për UIBM [i punuar në bashkëpunim me HERAS+], mund të jenë udhërrëfyes në caktimin e aktiviteteve për këtë periudhë.
- Fuqizimi i cilësisë në procesin mësimdhënës-mësimnxënës edhe në këtë semestër, le të jetë fokus i angazhimeve për të gjithë ne, krahas punës së përbashkët në përgatitjet e filluara për procesin e aplikimit për riakreditim institucional dhe programeve të reja të mundshme.

Me respekt!